



02-198

REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E SHTIMES/OPŠTINA ŠTIMLJE

Nr i Prot./Br Prot 02/30

Nr i Faqeve/Br.strana 9

Data/Dana: 04-04-2023

SHTIME/ŠTIMLJE



MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

në mes të

Komunës së Shtimes dhe Demokrasi Plus (D+)

Qëllimi i Memorandumit

Me qëllim të artikullimit të kërkesave të qytetarëve për përmirësim të shërbimeve publike nën përgjegjësi komunale përmes platformave elektronike, Komuna e Shtimes dhe Demokrasi Plus (D+) përmes këtij memorandumi shprehin vullnetin për të bashkëpunuar në pikat e mëposhtme:

1. Përdorimin e platformës elektronike ndreqe.com (ngakëtu 'platforma') për të adresuar ankesat e qytetarëve të Shtimes për përmirësimin e shërbimeve publike në lagjet dhe fshatrat e tyre;
2. Përdorimin e platformës elektronike ndreqe.com për të adresuar ankesat e qytetarëve për shkeljet mjedisore;
3. Komunikimin konstruktiv dhe angazhimin për të zgjidhur kërkesat dhe ankesat e qytetarëve të shtruar përmes platformës;
4. Informimin e qytetarëve për statusin e veprimeve të ndërmarra pas kërkesave dhe ankesave të qytetarëve në platformë.

Përgjegjësitë e D+:

Përmes këtij memorandumi, për të arritur synimet e lartpërmendura, D+ zotohet të:

- ┌ Mirëmbajtje dhe promovojë në mënyrë të paanshme politike një platformë që do të mund të shërbejë si medium për qytetarët e Shtimes që të raportojnë problemet me shërbimet publike në lagjet apo fshatrat etyre;
- ┌ Informojë në mënyrë të menjëhershme dhe të përshtatshme zyrtarët komunal për raportimet e qytetarëve në platformë;
- ┌ Raportoje në baza mujore zyrtarët komunal për gjendjen e raportimeve dhe rregullimeve në platformë; Më tutje të ofrojë hartat digjitale të komunës së Shtimes që saktësojnë çfarë kërkesa/ankesa janë raportuar dhe lokacionin e saktë në hartë digjitale;
- ┌ Lehtësojë komunikimin e komunës me qytetarët aktiv në platformë;
- ┌ Ofrojë asistencë teknike për zyrtarët komunal për përdorimin e platformave elektronike.



Përgjegjësitë e Komunës së Shtimes

Përmes këtij memorandum, për të arritur synimet e lartë përmendura, Komuna e Shtimes zotohet të:

- ┌ Angazhohet për trajtim të raportimeve të qytetarëve në lidhje me shërbimet publike komunale të regjistruara përmes platformës;
- ┌ Bëjë përpjekje që të zgjidh në kohë sa më të shkurtë kërkesat dhe ankesat e qytetarëve sipas mundësive kohore dhe buxhetore;
- ┌ Vë në gatishmëri resurset komunale që i kanë nën menaxhim për t'u përgjigjur kërkesave të administratorëve të platformës për gjendjen e kërkesave dhe ankesave të shtruara përmes platformës;
- ┌ Ofron një pjesë nga resurset komunale që i kanë nën menaxhim për t'i mbështetur qytetarët për gjendjen e kërkesave dhe ankesave të shtruara përmes platformës;
- ┌ Promovojë përdorimin e platformave tek drejtuesit e institucioneve komunale në mënyrë që të shërbej për ndërlidhje më të ngushtë me qytetarët aktiv të komunës.
- ┌ Të caktojë një zyrtar komunal si pikë kontaktuese për Demokraci Plus për realizimin e kësaj iniciative;
- ┌ Të sigurojë që zyrtarët komunal marrin pjesë në punëtoritë (sesione informuese mbi atë se si funksionojnë platformat) e paraparë nga Demokraci Plus.

Komuna e Shtimes dhe D+ pajtohen të mbajnë raporte konstruktive të ndërsjellët gjatë këtij bashkëpunimi dhe të respektohet pavarësia dhe paanshmëria politike e D+ si organizatë jo-qeveritare.

Ky memorandum do të hyjë në veprim në mënyrë të menjëhershme dhe të jetë efektiv për një kohë të pacaktuar. Memorandumi mund të amendamentohet në çdo kohë me pëlqimin e dy palëve, dhe në mënyrë periodike do të vlerësohen arritjet.

Qemajl Aliu
Kryetar i komunës së Shtimes



Data

Valmir Ismail
Drejtor ekzekutiv i D+



04.04.2023

Data